

VENDIM
Nr.12, datë 7.1.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.556, DATË 28.5.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ÇAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT
SHQIPTARË TË DËRGUAR NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE REPUBLIKËN E AFRIKËS
QENDRORE, NË KUADËR TË MISIONIT USHTARAK “MINURCAT” TË ORGANIZATËS
SË KOMBEVE TË BASHKUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të aktit normativ nr.1, datë 2.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin e një kompanie të Forcave të Armatosura në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë në misionin “MINURCAT”, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”, miratuar me ligjin nr.10114, datë 2.4.2009, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në pikën 1 të vendimit nr.556, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave, fjalët “...të jetë 60 (gjashtëdhjetë) euro ...” zëvendësohen me “...të jetë 9 000 (nëntë mijë) lekë...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha